



Pranuar / Dërguar Përmirësuar/Pradato Received/Delivered	08.08.2023	3	vite Year
Organ / Njësia Organ / Jednitsa Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Dilog Appendix	Sasia Kohësia Quantity
SKIMSHICK	5584/2023		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.899/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.899/2023 të datës 30.06.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] kundër Vendimit Nr.02/60280 të datës 21.06.2023 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Gjilanit, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.08.2023, mori këtë.

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.899/2023 të datës 30.06.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Komuna e Gjilanit më datë 15.03.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr. Reference: RN00011217 për grupin Specialit i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "Zyrtar i Gjendjes Civile 1", dy pozita, në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.

Në këto konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, i cili ka kaluar fazën e verifikimit paraprak ndërsa është ftuar të marr pjesë në testin me shkrim, duke u vlerësuar me gjithsej 57 pikë, ndërsa nga vlerësimi i jetëshkrimit ka marr gjithsej 8 pikë dhe nga numri i përgjithshëm i testit me shkrim dhe jetëshkrimit është vlerësuar me 65 pikë ku i është nënshtruar intervistës me gojë për të cilën është vlerësuar me 6 pikë ndërsa vlerësimi i përgjithshëm


ishte 71 pikë.

Ankuesi kundër vlerësimit më datë 17.06.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Pranimit. Komisioni i Pranimit më datë 21.06.2023 përmes Vendimit me numër protokolli 02/60280 ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi njoftimin e datës 16.06.2023.

Ankuesi, përmes emailit [ankesa.kpmschk@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschk@rks-gov.net), më datë 30.06.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.899/2022 me numër protokolli 4983/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitive Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 03.07.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Gjilanit. Ndërsa, Këshilli më datë 10.07.2023 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në ankesë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në lidhje me këtë ankesë ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 4983/2023 të datës 30.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 02/60280 të datës 21.06.2023 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Gjilanit; Konkursin me Nr. Reference: RN00011217 për grupin Specialit i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën *Zyrtar i Gjendjes Civile 1, dy pozita*, në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme; Ankesën e datës 17.06.2023; Dokument identifikimi për ankuesin; Certifikatën mbi dënimet penale 19.05.2023; Vërtetimin e datës 19.04.2023; Diplomën me Nr. 220/2011; Diplomë e datës 10.06.1998; Vërtetimi me Nr. 135/2012 i datës 02.11.2012; Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 01.08.2002-21.6.2023; Letër konfirmim për kryerjen e praktikës e datës 15.04.2014; Referencë e datës 05.11.2013; Kontratë mbi themelimin e marrëdhënies juridike të punës e datës 01.11.2012; Kontratë punë për kohë të caktuar e datës 01.06.2014, 02.06.2015; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 03.07.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 10.07.2023; Vendimin me Nr. 476 të datës 12.04.2023 për themelimin e komisionit për pranim; Lista e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar; Njoftim për verifikim paraprak; Emailin e datës 11.05.2023, 12.06.2023 për ankuesin nga F.H; Formularin për vlerësimin e CV-së; Formularin për vlerësimin e intervistës me gojë për ankuesin nga komisioni i datës 14.06.2023; Rendjen përfundimtare të kandidatëve e datës 14.06.2023; Njoftimin për rezultatet e vlerësimi i datës 16.06.2023; Njoftimin për përmbledhjen e vlerësimi i datës 22.06.2023; Aplikacionin e ankuesit; Aplikacionin e kandidatës F.M, Diplomën me Nr.1071, Diplomën me Nr. 862, Certifikatën për periudhën nëntor 2009 deri shkurt 2010, Certifikatën për periudhën 15.08.2011 deri 14.02.2012, Vërtetimin e datës 04.11.2010, 25.12.2012, 01.05.2023, 31.12.2013, Referencën e datës 25.12.2012, Dokument identifikimi i kandidatës F.M, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 02.05.2023; Aplikacionin e kandidatit M.Z, Diplomë me Nr. 132, Kontratë e Veçantë e marrëdhënies së punës e datës 10.07.2017, Vërtetimin Nr.Prot: 112/02 i datës 24.02.2022, Rekomandimin e datës 23.03.2023, Akt Emërimit e datës 04.02.2022, Dokument identifikimi i kandidat M.Z, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 30.03.2023.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit, është bërë i pamundur, *sepse*:

Nga administrimi shkresave të parashtruara nga kandidatët për pranim në shërbimin civil, ka gjetur se për të njëjtën procedurë të pranimit për grupin Specialit i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "Zyrtar i Gjendjes Civile 1", dy pozita, në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme të zhvilluar nga Komuna e Gjilanit, është evidentuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.06.2023 ka pranuar ankesë nga një kandidat në këtë procedurë respektivisht kandidati R.A, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me qëllim të shqyrtimit të ankesës së tij me datë 04.08.2023 ka nxjerr Vendimin me numër A.nr.875/2023, përmes të cilit e ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit R.A të datës 22.06.2023, ndërsa në pikën III të dispozitivit të këtij vendimi ka **anulluar** Vendimin me numër protokolli 02/60273/23 të datës 21.06.2023 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Gjilanit, konkursi me Nr.Reference: RN00011217 për grupin Specialit i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile 1, dy pozita, në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme si dhe të gjitha veprimet që ndërlidhen me të.

Andaj në rrethanat e rastit konkret lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit sikurse edhe me objektin e shqyrtimit të ankesës së tij, gjegjësisht konkursin për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "Zyrtar i Gjendjes Civile 1", dy pozita, në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme të zhvilluar nga Komuna e Gjilanit, Kolegji i Këshillit, konstaton se është vendosur sipas Vendimit me numër A.nr.875/2023, gjegjësisht aktet e nxjerrja si rezultat i kësaj procedurë janë anuluar siç është cekur si më lartë dhe është **obliguar** Kryetari i Komunës së Gjilanit dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi duke ndërmarr veprimet si në pikën III të këtij vendimi.

Prandaj nga se u tha si më lartë, pas rrethanave të krijuara juridike e në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*", Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse sipas Vendimit me numër A.nr.875/2023 të datës 04.08.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është anuluar konkursi për grupin Specialit i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "Zyrtar i Gjendjes Civile 1", dy pozita, në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme të zhvilluar nga Komuna e Gjilanit, atëherë ankesa e ankuesit nuk ka objekt shqyrtimi dhe mbi këtë bazë objekti i ankesës është bërë i pamundur apo i kotë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:**Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda,A.nr.899/2023, datë 07/08/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

